LIGJ
Nr. 51/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9741, DATË 21.5.2007, "PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimet "Ministria e Arsimit dhe Shkencës" dhe "Ministri i Arsimit dhe Shkencës" zëvendësohen përkatësisht me emërtimet "ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit" dhe "ministri përgjegjës për çështjet e arsimit".

Neni 2

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 5 dhe 6 ndryshohen si më poshtë:

"5. Në institucionet e arsimit të lartë publik, që kanë qendra spitalore universitare, departamentet përbëhen edhe nga shërbimet, të cilat formohen në bazë të specialitetit. Shërbimi realizon funksione diagnostikuese e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, si pjesë e spitalit universitar, si dhe funksione mësimore e kërkimore, si pjesë e institucionit të arsimit të lartë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.

6. Në institucionet e arsimit të lartë, që kanë qendra spitalore universitare, përgjegjësi i shërbimit është titullari i shërbimit. Kriteret e përzgjedhjes së përgjegjësit të shërbimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.".

2. Në pikën 6.2, paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 12/1 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

"1. Qendrat spitalore universitare janë njësi të sistemit arsimor dhe të sistemit shëndetësor. Ato realizojnë funksione diagnostikuese e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, si pjesë e sistemit shëndetësor, dhe funksione mësimore e kërkimore, si pjesë e institucionit të arsimit të lartë.

4. Veprimtaria e qendrës spitalore universitare rregullohet me statutin e saj, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.".

Neni 4

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.5.2014

Shpallur me dekretin nr. 8590, datë 5.6.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani